

Eshtë e rëndësishme:

1. Të hiqen thërrnjat nëpërmjet një krëhëri me dhëmbë të dëndur, menjëherë mbas lyerjes me ilaçin e zgjedhur.
2. Të kontrollohen rregullisht të gjithë pjesëtarët e familjes.
3. Të lahen çarçafët , këllëfët e jastekëve si dhe ndërresat me ujë të nxehtë (mbi 54°C); ato veshmbathje që nuk mund të lahen me ujë duhet të pastrohen në të thatë ose të mbyllen nëpër qese plastike për rreth 10 ditë.
4. Furçat dhe krëhërat duhen mbajtur të zhytura në ujë të nxehur mbi 54°C për jo më pak se 5 minuta ose të lyhen me produktin e zgjedhur për të çfarosur morrat.
5. Të kalohet aspirapolveri mbi divane, qilima dhe ndenjëset e automobilët.
6. Të përsëritet trajtimi me ilaç mbas 7-10 ditësh.

Eshtë gjithashtu e rëndësishme të dihet që :

- **Kthimi në shkollë lejohet vetëm mbasi të jetë bërë trajtimi me ilaçin e zgjedhur.**
- Në shkollë, fëmijët nuk duhen izoluar apo lënë mënjanë për shkak të morrave.
- Rregullorja e të vepruarit në raste të tilla mund të shkarkohet nga siti i ASL-it:
www.asl.varese.it/guidaaiservizi/bambini

VINI RE:

ESHTË I GABUAR PËRDORIMI I PRODUKTEVE PËR ÇFAROSJEN E MORRAVE NE SE NUK KA INFESTIM PREJ TYRE. BEN PERJASHTIM RASTI I SHOKEVE QE FLEJNE NE TE NJEJTIN SHTRAT ME PERSONIN E INFESTUAR NGA MORRAT.

Për hollësira të mëtejshme dhe këshilla mund t'u drejtoheni punonjësve të mjeksisë të Distriktit Tuaj Socio-Sanitar.

PO TE DUASH TE DISH ME SHUME:

[www.epicentro.iss.it/argomenti di salute/gli altri/pediculosi](http://www.epicentro.iss.it/argomenti%20di%20salute/gli%20altri/pediculosi)
[www.ministero.salute.it/prevenzione/malattie infettive/educazione sanitaria/pediculosi](http://www.ministero.salute.it/prevenzione/malattie%20infettive/educazione%20sanitaria/pediculosi)
www.ilpidocchio.it
www.cdc.gov/ncidod/dpd/parasites/lice/factsheet_head_lice_treating.htm



A.S.L.
Azienda
Sanitaria
Locale
della
Provincia di
VARESE

**DIREZIONE SANITARIA
DIPARTIMENTO DI
PREVENZIONE MEDICO
SERVIZIO MEDICINA PREVENTIVA
NELLE COMUNITA'**



**PARANDALIMI I PEDICULOSI-t
(mbushjes me morra) NE SHOQERI**

PA MORRA



Vizatoi: Giorgia Donà

Axhornimi i 4-t - shkurt 2008
Shërbimi Mjeksisë Parandaluese nëpër Komunitete



Cikli i jetës së morrit

Morri i kokës është një insekt i vogël, me ngjyrë gri të lehtë, pa krahë, me trup të sheshtë dhe me këmbë të pajisura me një grip të veçantë, që i lejon të mbërthehet fort mbas flokëve dhe qimeve në përgjithësi; ka gjithashtu një aparat çpues me të cilin çpon lëkurën dhe thith gjakun. Është një parazit (organizëm që jeton "në kuriz" të organizmave të tjerë) dhe ushqehet duke pickuar pjesën e trupit ku ngjitet. **Jeton dhe riprodhohet vetëm mbi njerëzit** (flokë, qerpikë, vetulla, mjekër), duke preferuar sidomos pjesën e qafës dhe atë mbas veshit. Shenja kryesore, që mund të mos vihet re, është të krojturit e shkaktuar nga reaksioni alergjik ndaj pështymës së parazitit.

Nuk paraqet rrezik për shëndetin, mbasi nuk transmeton asnjë lloj sëmundjeje.

Ngjitja bëhet sidomos nëpërmjet prekjës drejt përsëdrejti kokë me kokë ose edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, nëpërmjet prekjës së sendeve të përdorimit personal si p.sh. krëhëra, furça, kapele, shalle, e tjerë.


Mjaftojnë 30 sekonda që një morr të kalojë nga një kokë në një tjetër.

Larg lëkurës së kokës paraziti nuk mund të mbijetojë për më shumë se 24 – 48 orë.

Femra e morrit, gjatë 3-4 javëve të jetës, pjell nga 100 deri në 300 vezë (thërrija), mesatarisht 5 në ditë.

Thërrijat, me ngjyrë të çelur, me formë vezake dhe gjatësi prej rreth 1 milimetri, ngjiten tek rrënja e flokut, pak milimetra larg lëkurës së kokës, nëpërmjet një ngjitseje natyrale, që tretet me vështirësi, dhe ndjekin rritjen e flokëve.

Mbas 6-10 ditësh ato çelin në formën e një **nimfe** e cila, mbas 7-13 ditësh të tjera, shndrohet në një **morr të rritur**.



Masa parandaluese

Është pothuajse e pamundur të parandalohet krijësisht mbushja me morra. Fëmijët, sidomos kur jetojnë mes të tjerëve, janë të prirur për të patur prekje të vazhdueshme e të drejtpërdrejta dhe për kohë të zgjatur me kokat e njëri tjetrit, është i mundshëm gjithashtu edhe shkëmbimi i sendeve personale (kapelet, etj.).

Mbushja me morra nuk mvaret nga gjatsia e flokëve, as nuk do të thotë që je i pistë, është një diçka që mund të vërehet në të gjitha shtresat e shoqërisë.

Masat e mëposhtme parandaluese kanë treguar një efikasitet të mirë:

- të ushtrohet një **mbikqyrje e kujdesshme**, nëpërmjet kontrolleve (sidomos mbi qafë dhe mbas veshëve) në rastet e larjes së kokës, për t'u siguruar për mungesën e thërrijave. Përdorimi i krëhërit me dhëmbë të dëndur mund të jetë shumë i vlefshëm në këtë fazë.
- të edukohen fëmijët që të mos shkëmbejnë sendet e pëdorimit personal si krëhëra, kapele, shalla, rripa flokësh, kapse flokësh, etj.);
- të edukohen fëmijët që të mos i përziejnë rrobat (do të ishte mirë që, sidomos nëpër shkolla dhe palestra, çdo fëmijë të kishte dollapin e tij);
- të ushtrohet kontroll i herë pas herëshëm ndaj gjithë pjesëtarve të familjes, sidomos ndaj fëmijëve, në rast të mbushjes me morra.

Trajtimi

Janë në shitje një numër i madh produktesh por jo të gjithë kanë dhënë prova të efikasitetit të tyre. **Produkti që do të përdoret duhet të jetë i përshkruar nga mjeku, që do të këshillojë atë më të përshtatshmin, për përdorimin e të cilit duhet ndjekur me kujdes ajo që është shkruar tek fleta përshkruese e ilaçit.**

Është mirë që të zgjidhen produkte në formë kremi, xheli, shkume ose lëngu, mbasi janë më të përqëndruara dhe më efikaçe. Ndërsa është mirë të mos përdoren produktet në formë shampoje.

Produktet duhen mbajtur në vënde të paarrtshëm nga ana e fëmijëve.

Permetrina në 1% është ndër ilaçet më efikaçe kundër morrave. Është një lloj piretroide sintetik që vret jo vetëm morrat por edhe vezët dhe, ndryshe nga piretrinatin natyral, nuk shkakton alergjira tek personat e ndjeshëm ndaj krizantemit. Tolerohet mjaft mirë nga përdoruesit, edhe pse mund të ndodhë shfaqja e reaksioneve në disa zona të lëkurës; çkëshillohet përdorimi i këtij ilaçi poshtë moshës prej 6 muajsh. Zotëron një efekt mbetës të aftë të shkatrojë ninfat që dalin nga vezët dhe që s'janë vrarë nga ilaçi.

Kremi me permetrinë shpërndahet mbi flokëi, lihet të veprojë për rreth 10 minuta dhe shplahet me ujë të bollshëm.

Mund të përdoren edhe ilaçe të tjera, që përmbajnë piretrinë dhe piperonilbutossido ose malathion në 0,5%.

Shiten edhe produkte që veprojnë në mënyrë fizike: dimeticone në 4%, që i mbulon morrat dhe vezët me një cipë që i mbyt dhe një përzierje vajrash natyralë që bllokojnë aparatit e frymëmarrjes të insektit.